

Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri



Faqe 4

"Për ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës"

Iniciativa të realizuara përmes programit të granteve të vogla



Faqe 9

Ndihmë ligjore të mbijetuarve të tragjedisë në Gërdec



Faqe 13



Konferenca e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara mbi "Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara"

Faqe 3

Planet lokale për zbatimin e "Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të personave me aftësi të kufizuara"

Faqe 5



Raportoi: Ganimete Beqiri Koordinatore "Handikap Kosova"

Shoqëria civile dhe përpjekjet për gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Faqe 14

NË KËTË NUMËR

Fjalim i Oficerit te Programit te USAID, Z.John Brannaman 3	Konferencën e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara mbi "Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara"
Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri 4	
Trajnimet në fushën e përshtatshmërisë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar 4	
Planet lokale për zbatimin e Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të personave me aftësi të kufizuar 5	
Raporti i Monitorimit mbi Zbatimimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar 5	
Çmime "Për arritjen më të mirë në zbatim të strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar" 6	
Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi 7	Roli dhe ndikimi i tij në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar
"Small Steps" - Hapa Te Vegjël 8	Raport Vlerësimi mbi Zbatimin e Standardeve për Shërbimet Shoqërore për Individët me Aftësi të Kufizuara në Qendrat Ditore dhe Rezidenciale
"Për ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës" 9	Iniciativa të realizuara përmes programit të granteve të vogla
"Promovimi i përmirësimit të kuadrit ligjor Shqiptar, me synim përputhjen e tij me standardet ndërkombëtare të BE dhe OKB, për të mundësuar shanse të barabarta dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri" 10	
Reforma zgjedhore dhe Aftësia e Kufizuar 11	
Përgjegjësia Sociale e Biznesit ndaj Njerëzve në Nevojë 12	
Ndihmë ligjore të mbijetuarve të tragjedisë në Gërdec 13	
Trajnim " Teknika te Punes Kerkimore dhe Vleresimit te Programeve" 13	
Shpirti human dhe ndërgjegjësimi i qytetit të Korçës i riktheu shikimin nxënësit K. R 14	
Shoqëria civile dhe përpjekjet për gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë 14	



SFIDA 27

Revistë e
Financuar nga:
Komiteti Suedez i Helsinkit
për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

BASHKËPUNËTORË

Blerita Çani
Bardhylla Kospiri
Narbis Ballhysa
Florida Kalemi
Entila Zyba
Evis Mico

DESIGN AND LAYOUT

Orest Muça

ADRESA

Ruga "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi) nr. 15,
kat i 3, Tiranë Shqipëri.

Tel: ++355 4 269426

E-mail: adrf@albmail.com

www.adrf.org.al

Fjalim i Oficerit të Programit të USAID, Z. John Brannaman mbajtur në

Konferencën e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara mbi "Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara"

Zonja e Zotërinj,

Në emër të USAID do të doja të thoja se është një privilegj që të marr pjesë në këtë konferencë. Qëllimi kryesor i asistencës së Sh.B.A.-së në Shqipëri dhe kudo tjetër është të ndihmojë që grupe personash të kenë një zë në arenën politike për të mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat e qytetarëve dhe për të marrë pjesë plotësisht dhe aktivisht në jetën demokratike. Ligji Amerikan ka pranuar prej një kohe të gjatë se të drejtat qytetare duhet t'u ofrohen si personave me aftësi të plota, ashtu edhe atyre me aftësi të kufizuara; dhe gjate viteve të fundit, falë ndryshimeve në politikat e qeverisë përpjekjet e organizatave të tilla si Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), jam i kënaqur të shoh se ligji Shqiptar dhe praktikat në vend, kanë nisur të lëvizin në të njëjtin drejtim. Për këtë arsye USAID është krenar që e mbështet. Prej shumë vitesh FSHDPAK ka udhëhequr luftën kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara. Fondacioni ka avokatuar për ligje dhe politika që zvogelojnë stigmatizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe ka promovuar përfshirjen e tyre në shoqëri, duke dalë shpesh kundër çdo pritjeje.

FSHDPAK ka ofruar shërbime të vlefshme për personat me aftësi të kufizuara, një shembull i shkëlqyer i së cilës është projekti për karriget me rrota, mbështetur nga USAID. Ky projekt, që ofron karrige me rrota, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara, ndikon në menyrë të drejtpërdrejtë mbi jetën dhe mbi mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të tyre. Ai ju ofron personave me aftësi të kufizuara mundësi të reja për integrim dhe pjesëmarrje sociale.

FSHDPAK luan gjithashtu një rol kryesor për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ky dokument ka ndihmuar në përmirësimet ligjore dhe ka lobuar në mënyrë aktive për Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, miratimi i së cilës në vitin 2005 ishte një ngjarje me rëndësi brenda kuadrit ligjor që mbështet të drejtat e njeriut. E rëndësishme është që FSHDPAK ka monitoruar me sukses Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Do të doja të përgëzoja Znj. Çani dhe personelin e FSHDPAK për metodat strikte dhe analizën e objektivave që kanë mundësuar prodhimin e këtij raporti të shkëlqyer.

Ajo që del qartë në këtë raport është se ndërsa rrethanat për personat me aftësi të kufizuara në



Shqipëri janë ende shumë të vështira, ato po ndryshojnë gradualisht për më mirë. Ka pasur progres në lidhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, që është një lajm i mirë për të gjithë qytetarët me aftësi të plota dhe të kufizuara. Ka ende vend për përmirësimet nga Qeveria për ato që ofron përvoja u perket termave dhe premtimeve në strategji. Fatmirësisht, ky raport jo vetëm që ofron "diagnozën" por edhe "kurimin" që duhet ndjekur prej pushtetit vendor dhe qendror në menyrë që të fuqizojë zbatimin e Strategjisë.

Do të doja të inkurajoja zyrtarët që të bëjnë një lexim të kujdesshëm të raportit dhe të reflektojnë mbi rekomandimet e parashtruara, të cilat janë praktike dhe të realizueshme. Nëse ky raport ndihmon që njerëzit të dallojnë se ku duhen bërë përmirësimet dhe i bënë njerëzit të shumfishojnë përpjekjet për realizimin e Strategjisë, atëherë ai i ka shërbyer një qëllimi të dobishëm. Ky është monitorimi dhe avokatia efektive, për të cilën FSHDPAK meriton të lavdërohet dhe të cilën USAID është krenar që e mbështet.

Prandaj, urime FSHDPAK!

Vazhdoni punën e mirë që po bëni!

Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota", mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) gjatë periudhes Dhjetor 2007 - Qershor 2008 ka vazhduar aktivitetin për të përmbushur realizimin e objektivave të tij;

A. Projekti mbështet aktivitetin e punishtes " Mirësia" e vetmja këtij lloji në Shqipëri në të cilën prodhohen karrige me rrota dhe janë të punësuar 5 persona me aftësi të kufizuar, 2 prej të cileve përdorues të karrigeve me rrota. Gjate kesaj periudhe jane prodhuar 165 karrige me rrota dhe kanë përfituar persona me aftësi të kufizuara në nevojë për to, sipas specifikave individuale që ata kane, në rajone te ndryshme te vendit. Personave me aftësi të kufizuar të cilët janë pajisur me karrige me rrota dhe familjarëve të tyre u është ofruar informacion si për



mënyrën e përdorimit të karriges me rrota ashtu edhe për çështje të cilat kanë të bëjnë me llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar. Për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit të punishtes por edhe për të plotësuar nevojat e sa më shumë PAK në nevojë për karrige me rrota, është lobuar nga FSHDPAK përmes programit të avokatisë në nxitjen e MPÇSSHB për zbatimin e politikave subvencionuese për shërbimet në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota. Nuk ka patur rezultate konkrete në këtë drejtim. Ndërkohë është lobuar për përfshirjen e biznesit në subvencionimin e prodhimit të karrigeve me rrota.

Është siguruar mbështetje nga Procredit Bank dhe Fondacioni VODAFONE - Shqipëri.

B. Me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, FSHDPAK përmes projektit ka influencuar gjithashtu në ngritjen e kapaciteteve të OJF-ve të fushës së aftësisë së kufizuar si dhe të gjithë aktorëve përgjegjës për zbatimin e SKPAK. Bazuar në planin e aktiviteteve janë zhvilluar 6 trainime në 6 rajonet target të projektit (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Durrës dhe Korçë). Trainimet u fokusuan në çështjet e përshtatshmërisë dhe lëvizjes pa barriera të PAK. Pjesëmarrësit në trainime



ishin 94 përfaqësues/ specialistë (inxhinierë, arkitektë) të institucioneve përgjegjëse të tilla si; Bashki, Prefektura, Keshillat e Qarkut, Keshillat e Rregullimit të Territorit, Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik,

Drejtoritë Arsimore si dhe përfaqësues te bizneseve të ndërtimit. Në trainimin e zhvilluar në Tiranë morën pjesë gjithashtu specialistë të MPPTT. Trainimet shërbyen për të ngritur kapacitetet e aktorëve përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e përshtatshmërisë të SKPAK.

Planet lokale për zbatimin e Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të personave me aftësi të kufizuar

C. Po në kuadër të ngritjes së kapaciteteve por edhe të nxitjes së zbatimit të SKPAK në nivel lokal, u organizuan 5 seminare përkatësisht në rajonet Korçë, Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Elbasan. Seminaret u fokusuan në; prezantimin në nivel lokal të strukturës shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të SKPAK; rëndësinë e shtrirjes së saj në nivel lokal, gjetjet dhe rekomandimet e raportit të parë të monitorimit të SKPAK kryer nga FSHDPAK me mbështetjen e USAID si dhe në hartimin e planeve lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK. Pjesmarrja në seminare e 167 përfaqësuesve, specialistë të institucioneve dhe subjekteve përgjegjëse për zbatimin e SKPAK në nivel



lokal (Prefekturë, Bashki, Komuna, Drejtori Arsimore, Drejtori të Punesimit, Drejtori të Shëndetit Publik, Urbanistikës, OJF) dëshmoi interesin dhe rëndësinë që këto institucione i kanë dhënë zbatimit të SKPAK. Në përfundim, u hartuan 5 plane lokale. FSHDPAK do të vazhdojë bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse në nivel lokal për miratimin dhe me pas zbatimin e planeve lokale.

Raporti i Monitorimit mbi Zbatimimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar

D. Zbatimi i objektivave të projektit gjate kesaj periudhe konsistoi gjithashtu edhe në prezantimin e raportit të parë të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK për vitin 2006. FSHDPAK me mbështetjen e Agjensisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID), zhvilloi një analizë të ecurisë së Qeverisë Shqiptare në zbatimin e kësaj strategjie.

Kjo përpjekje u materializua në botimin e raportit të parë monitorues mbi aftësinë e kufizuar në Shqipëri, të titulluar "Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar: Raporti Monitorues", i cili përmban pesë vlerësime mbi; përshtatshmërinë, shërbimin shëndetësor, shërbimin social, arsimin, punësimin si dhe formimin profesional në gjashtë qytete kryesore të Shqipërisë: Tiranë,

Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë e Vlorë.

Për të bërë prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të monitorimit FSHDPAK me mbështetjen e USAID organizoi me 19 Shkurt 2008 në ambientet e Hotel Tirana Internacionale konferencën "Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar. Raporti i parë i monitorimit. Gjetje dhe Rekomandime". Zbatimi i projektit "

Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri" mbështetur nga USAID ka influencuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota si dhe ka ndikuar në nxitjen e strukturave qeveritare në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.





Çmime "Për arritjen më të mirë në zbatim të strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuara"

Ne 19 Shkurt 2008, në Konferencën Kombëtare, për lancimin e raportit të parë të Monitorimit të Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara, u shpallën gjithashtu Organizatat Fituese të Çmimit "Për Arritjen më të Mirë në Zbatim të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara".

Organizatat u përzgjedhën nga një bord ekspertesh, gjatë një procesi të hapur aplikimi, mbi bazën e disa kriterëve. Çmimet, jo vetëm promovuan organizatat aktive në procesin e zbatimit të strategjisë, por ato përmes një vlerësimi financiar mundësuan realizimin e aktiviteteve të tjera në funksion të përmbushjes së misionit të organizatave fituese.

6(gjashte) organizatat fituese, me çmimin e ofruar, bënë të mundur realizimin e disa aktiviteteve specifike. *Organizata "MEDPAK"* ndërtoi faqen e saj të internetit, si një mjet të domosdoshëm për komunikim me publikun si brenda dhe jashtë vendit, duke ndikuar në fuqizimin organizativ e institucional të organizatës. Trajnimi i një rrjeti prindërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore, në qytetin e

Librazhdit në fusha si avokati, por dhe në mënyrën e përdorimit të internetit, i shërbeu krijimit të kapaciteteve të nevojshme me ndikim në rritjen e aksesit në informacion si dhe përdorimin e tij si mjet në fushat e avokatisë për të bërë të mundur realizimin e ndryshimeve dhe përmirësimit e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre. *Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës të Shqipërisë*, vazhdoi me tej aktivitetin e vet të fokusuar në nxitjen e përmirësimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor për punësimin e invalidëve të punës dhe kategorive të tjera të njerëzve me aftësi të kufizuara.

Shoqata "Ndiqmoni Jetën" përgatiti dhe botoi një material prezantues për aktivitetin e organizatës, në kuadrin e 10 vjetorit të krijimit dhe funksionimit të saj. Ky material ofroi mundësi për organizatën, të reflektojë dhe të pasqyrojë në një botim serioz, përpjekjet e vazhdueshme të një grupi aktiv prindërisht që me durim dhe gradualisht kanë arritur të krijojnë shërbime komunitare për fëmijët dhe familjet e tyre, kanë arritur të zgjerojnë rrjetin e të kenë shtrirje në 12 rajone të vendit, të jenë aktiv në

fushat për përmirësimin e statusit të personave me aftësi të kufizuara mendore në Shqipëri. *Shoqata "Për Gratë dhe Fëmijët"* Kombinat, me aktivitete në një zonë periferike dhe problematike të Tiranës, përmes çmimit të ofruar, bëri të mundur realizimin e disa aktiviteteve, një prej të cilave ishte hapja e një ekspozite me punimet e realizuara nga klientët e qendrës gjatë seancave të terapisë okupacionale dhe rehabilituese. Ekspozita, krijoi mundësinë për të sjellë sëbashku në ditën e 1 Qershorit fëmijë me dhe pa aftësi të kufizuara, prindër, përfaqësues të shoqërisë civile, të autoriteteve nga pushteti lokal dhe ai qendror, me synim për të tërhequr dhe njëherë vëmendjen ndaj nevojës për kujdes dhe mbështetje të mjaftueshme, që do të mundësonte rehabilitimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. *Shoqata "Për Rehabilitim Fizik"* në Korçë, e vlerësuar për ofrimin e shërbimit të fizioterapisë ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara, përmes grantit mundësoi blerjen e një pajisjeje të re për fizioterapi, terapi intensive për 6 persona me aftësi të kufizuara, si dhe trajnim të një grupi prindërisht prej 26 personash për ofrimin e ushtrimeve baze për fizioterapi. *Shoqata "MISSAK"* përgatiti dhe botoi një autobiografi të piktorese se talentuar Rudina Proda, si një instrument për promovimin e talentëve në fushën e artit dhe kulturës edhe mes njerëzve me aftësi të kufizuara. Kjo eksperience e parë e dhënies së çmimeve për punën me të mirë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me aftësi të kufizuara, përbën një mekanizëm, që paralelisht me instrumente të tjerë, do të nxiste përshejtimin e zbatimit të masave që parashikon plani i veprimit të Strategjisë Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar.



Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi

Roli dhe ndikimi i tij në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar

I krijuar në Qershor 2007, duke patur në përbërje të tij 24 anëtarë, "Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi" ka zhvilluar një serë aktivitetesh për realizimin e misionit të tij për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet një bashkëpunimi aktiv dhe eficient, nepërmjet shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës mes anëtarëve dhe agjensive të tjera për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit.

Për një ecuri normale të punës së tij, Koalicioni diskutoi dhe miratoi nje Aneks - Marreveshje e cila u firmos nga organizatat anëtare themeluese të Koalicionit si edhe zgjodhi strukturat drejtuese të tij. Gjithashtu u përgatit dhe u miratua një plan aktivitetesh për periudhën Janar 2008 - Qershor 2009, ku anëtarë të Koalicionit shprehën predispozicionin për të kontribuar në realizimin e tyre.

Gjatë vitit 2008 roli mbështetës i Koalicionit për nisma të ndërmarra nga organizata të aftësisë së

kufizuar, anëtare të tij, ndikoi pozitivisht për realizime në fushën e përmirësimeve ligjore si edhe zbatim legjislativ. Koalicioni mbështeti nismën e Grupimit të Shoqatave të Aftësisë së kufizuar mendore, të ngritur pranë FSHDPAK, për nxitjen e qeverisë në hartimin dhe miratimin e statusit të personave me aftësi të kufizuar mendore. Mbështetja e Koalicionit në tërësi si edhe përfshirja direkte e institucionit të Avokatit të Popullit, anëtar i Koalicionit, realizuan marrjen e përgjegjësisë nga MPÇSSH për ngritjen e grupit të punës për statusin e personave me aftësi të kufizuar mendore si dhe planifikimin për finalizimin e këtij procesi deri në fund të vitit 2008.

Koalicioni mbështeti gjithashtu nismën e Grupimit të shoqatave të organizuar nga FSHDPAK për paraqitjen e një pakete rekomandimesh ligjore për përmirësimin e Kodit Zgjedhor për të realizuar respektimin e të drejtës së votes për të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuar, duke shpërndarë në rrejtin e bashkëpunëtorëve një Letër të Hapur. Këto kërkesa u prezantuan nga drejtuesit e Koalicionit edhe në takimin me ambasadorin e OSBE z.

Bosch dhe stafin e tij.

Përpjekjet e organizatave të aftësisë së kufizuar për të mos lejuar vazhdimin e ndërtimeve me pengesa ndërtimore për personat me aftësi të kufizuar, Koalicioni i mbështeti me një "Deklaratë thirrje" për moslejimin e vazhimit të ndërtimeve me barriera për personat me aftësi të kufizuar, që u shpërnda në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe në rrejtin e bashkëpunëtorëve.

Në kuadrin e një projekti të FSHDPAK, mbështetur nga World Learning/Forecast, u zhvillua një vizite studimore në Irlandë. Pjesë e grupit përfaqësues ishin edhe disa organizata anëtare të Koalicionit. Kjo vizitë u vlerësua shumë e domosdoshme dhe e suksesshme sidomos në përfitimin e eksperiencës nga organizatat anëtare të Koalicionit që nuk kanë në fokus çështjet e aftësisë së kufizuar, duke i nxitur për të gjetur hapësira gjithpërfshirëse brenda programeve të tyre.

Koalicioni po vazhdon punën sipas planit të tij të aktiviteteve, aktivitete të cilat do të mundësohen financiarisht nga World Learning/FORECAST.

Raport Vlerësimi mbi Zbatimin e Standardeve për Shërbimet Shoqërore për Individët me Aftësi të Kufizuara ne Qendrat Ditore dhe Rezidenciale

1 5 muaj pas aprovimit të Standardeve të Shërbimeve Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara ne Qendrat Ditore dhe Rezidenciale (Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr 822, date 12/06/06) Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, realizoi një vëzhgim, me synim analizimin e hapave të ndërmare dhe rezultatet konkrete ne lidhje me zbatimin e tyre ne qendrat ditore dhe rezidenciale qe ofrojnë shërbime ndaj klientëve me aftësi të kufizuara mendore, si dhe respektimin e të drejtave të tyre brenda kuadrit të standardeve.

Për realizimin e studimit me 12 Shkurt 2008, u nënshkrua një Marrëveshje Bashkëpunimi mes Drejtuesve të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtuesve të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Vëzhgimi u realizua gjate periudhës Shkurt-Prill 2008, dhe u shtri ne 26 qendra ditore dhe rezidenciale (publike dhe private) në mbarë vendin të cilat ofrojnë shërbime për 564 persona me aftësi të kufizuara mendore.


Ne vëzhgim u përfshinë përmes intervistave, diskutimeve ne grup, plotësimit të pyetësorëve si dhe formularëve të vëzhgimit, klientë të të gjitha grup moshave, pjesëtarë të familjeve të klientëve të qendrave ditore e rezidenciale, staf i qendrave ditore e rezidenciale si dhe drejtuesit e këtyre qendrave. Pjesë e rëndësishme e vëzhgimit ishte dhe studimi i dokumentacionit përkatës në ndihmë të zbatimit të standardeve.

Gjetjet kryesore të vlerësimit bëjnë të njohura fakte në lidhje me një nivel të mirë të njohjes së standardeve nga stafet dhe

drejtuesit e qendrave, por konstatohen ritme të ulta në drejtim të fillimit të planifikimit të punës për zbatimin e tyre. Situata aktuale në qendrat e zhvillimit (të fokusuar kryesisht tek personat me aftësi të kufizuara mendore) krahasuar me kriteret që përcaktojnë zbatimin e standardeve, paraqitet paksa kënaqshëm përse i përket vlerësimit dhe hartimit të planeve individuale; promovimit të pavarësisë, gjithëpërfshirjes dhe vetëvendosjes; trajtimit të barabartë dhe procesit të ankimimit.

Gjithë procedurat e shërbimit për qendrat e zhvillimi, duhet të rishkruhen për të reflektuar kriteret e përcaktuara në standarde. Procedurat e reja duhet të përfshijnë procesin e monitorimit të shërbimit. Të dhënat e vëzhgimit gjithashtu tregojnë se rralle tërhiqet opinioni i klientëve. Duhet punuar shumë për t'i kthyer prindërit në "pjesëmarrës aktiv" në vlerësimin dhe hartimin e planeve individuale. Mbetet ende shumë për tu bërë, që të mundësohet që gjithë personat me aftësi të kufizuara, përfitues të shërbimeve sociale në qendrat ditore dhe rezidenciale të gëzojnë të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike mbi bazat e barazisë sikurse gjithë bashkëmoshatarët e tyre, si dhe tu garantohet mbrojtja nga çdo lloj shfrytëzimi apo abuzimi. Për të garantuar respektimin e të drejtave është e nevojshme që çdo qendër ti përfshijë ato në politika dhe procedura të shkruara.

Realizimi i këtij studimi u bë i mundur përmes mbështetjes financiare të Cordaid, në kuadrin e programit të FSHDPAK për "Ofrimin e Shanseve të Barabarta për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara ne Shqipëri"



Iniciativa te realizuara permes programit te granteve te vogla

Prej dy vjetësh, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) dhe Mobility Internacional (MIUSA) po zbaton në Shqipëri projektin "Për Ndërtimin e një Komuniteti Gjithëpërfshirës," projekt i mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky projekt ka synuar nxitjen e pjesëmarrjes së njerëzve me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë

partnere në fushën e zhvillimit, kryesisht kontraktorë të USAID-it dhe agjenci të tjera zhvillimi që punojnë në Shqipëri. U ndihmuan OJF-te e AK për të formuluar idetë e projektit, për të identifikuar dhe siguruar bashkëpunim dhe partneritete. Njekoheisht FSHDPAK sherbeu si pike kontakti dhe si burim informacioni për MIUSA-n për sa i përket projekt propozimeve. Gjate gjithë periudhës së implementimit të projekteve, FSHDPAK organizoi takime dhe

synon të sigurojë përfshirjen reale dhe të suksesshme të femijeve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara në arsimin publik. Ky projekt u zbatua në bashkëpunim me zyrën "Partners for Hope" të World Vision-it, një organizatë për zhvillim ndërkombëtar. MDPKAM-i organizoi një fushatë ndergjegjesuese me qëllim vendosjen e bashkëpunimit midis pushtetit vendor, Drejtorisë Rajonale të Arsimit të rrethit të Elbasanit, prindërve, mesuesve dhe specialistëve të fushës. Ky projekt përfshiu gjithashtu median lokale përmes organizimit të një debati televiziv mbi çështjet e aftësive të kufizuara në komunitet. MDPKAM-i ofroi një sërë seminaresh për prindërit, mesuesit dhe nxenesit në 4 shkolla me qëllim zbatimin e praktikave përfshirëse në arsim.



grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në programet për zhvillim ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe në programe të tjera zhvillimi.

Në kuadrin e këtij programi, u realizua dhe ofrimi i granteve të vogla për mbështetjen e projekteve dhe nismave të bashkëpunimit që synonin përmbushjen e objektivit të sipërpërmendur.

FSHDPAK ofroi mbështetje dhe asistencë teknike, lehtësoi bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet organizatave aplikuese për grante dhe organizatave

komunikim të vazhdueshëm me fituesit e granteve duke ndihmuar në identifikimin e praktikave më të mira, në adresimin e sfidave dhe vështirësive si dhe në ofrimin e rekomandimeve për të arritur rezultate sa më të suksesshme.

Në vijim mund të gjeni një informacion të përmbledhur të projekteve.

1- Përfshirja e Femijeve me aftësi të kufizuara (AK) në arsimin publik

MDPKAM është një organizatë e prindërve e cila përmes këtij projekti

2 - "Ndryshimi do të thotë Përmirësim: Përmirësohemi së bashku, Jetojme së bashku"

MEDPAK, një grup simotër avokatie në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Amerikan, kontraktor i USAID zbatuan një projekt që kishte për qëllim rritjen e ndergjegjesimit në lidhje me gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe çështje që lidhen me shëndetin dhe aftësitë e kufizuara në programet e shëndetit me anë të personelit mjekësor dhe rrjeteve të tyre vullnetare. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, MEDPAK-u organizoi një fushatë ndergjegjesimi në

Peshkopi, nje qytet ne veri-lindje te Shqiperise. Tema e fushates se ndergjegjesimit ishte "Programe shendetesore qe perfshijne edhe aftesite e kufizuara".

3- "Planifikimi familjar dhe edukata seksuale per personat me aftesi te kufizuara mendore dhe fizike"

Shoqata "Ndihamoni Jeten" dhe "Shoqata e Distrofise Muskulare", ne partneritet me "Shoqaten Shqiptare te Planifikimit Familjar" (nje organizate zhvillimi) punuan per realizimin e planifikimit familjar dhe te edukates seksuale per personat me aftesi te kufizuara mendore dhe fizike. Takimet dhe seminarat kishin dy objektiva: ngritjen e

kapaciteteve te sfafit mjekesor dhe ekipeve te organizatave zbatuese dhe edukimin e te rriturve dhe te rinjve me aftesi te kufizuara dhe familjet e tyre per trajtimin e çeshtjeve te seksualitetit dhe planifikimit familjar.

4- Zhvillimi ekonomik, punesimi dhe aftesite e kufizuara: Krijimi i nje komuniteti gjithepershires biznesi

Projekti u zbatua nga "Shoqata Shqiptare e Invalideve te Punes" (ALIA), nje organizate kombetare qe nxit te drejtat e personave me aftesi te kufizuara ne fushat ekonomike, shoqerore, te punesimit, arsimit dhe rehabilitimit. ALIA, ne bashkepunim me Fondacionin Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te

Kufizuara (FSHDDPAK) dhe me Projektin per Zhvillimin e Ndermarrjeve dhe Sherbimeve te tregut te eksporteve (EDEM) te financuar nga USAID-i punuan per organizimin e seminareve per njohjen e komunitetit te biznesit me procedurat gjitheperفشirese te punesimit, me legjislacionin shqiptar mbi te drejtat e personave me aftesi te kufizuara dhe me modelin social te te drejtave te kufizuara. Ekipet e ALIA-s, FSHDDPAK-ut, EDEM-it dhe ato te komunitetit te biznesit bashkepunuan ne seminare dhe takime per te diskutuar dhe zbatuar strategji qe nxisin mundesite e punesimit per personat me aftesi te kufizuara.

Promovimi i përmirësimit të kuadrit ligjor Shqiptar, me synim përputhjen e tij me standardet ndërkombëtare të BE dhe OKB, për të mundësuar shanse të barabarta dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (FSHDDPAK) me mbështetjen financiare të UNICEF, realizoi në Shtator 2007 raportin studimor "Analizë vlerësuese e pajtueshmërisë të legjislacionit Shqiptar me instrumentet ndërkombëtarë, Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Legjislacionin e Komunitetit Evropian". Analiza pati si qëllim, në plan krahasimor, pajtueshmërinë e legjislacionit Shqiptar me standardet e Konventës së OKB për personat me aftësi të kufizuara, nenet specifike të Konventës të të Drejtave të

Fëmijëve (OKB, 1989) dhe Legjislacionin e Komunitetit Evropian, si dhe identifikimin e mangësive ligjore dhe financiare jo vetëm në kuadrin ligjor por edhe në dokumentet politik të Qeverisë Shqiptare, pjesë e çështjes së aftësisë së kufizuar.

Në vazhdimësi të kësaj inisiative, FSHDDPAK realizoi në 12.06.2008 tryezën e rrumbullakët "Promovimi i përmirësimit të kuadrit ligjor Shqiptar, me synim përputhjen e tij me standardet ndërkombëtare të BE dhe OKB, për të mundësuar shanse

të barabarta dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për të gjithë



Reforma zgjedhore dhe Aftësia e Kufizuar

Fillimi i reformës zgjedhore dhe ngritja e Komisionit Parlamentar për këtë çështje, nxitu sërish FSHDPAK, mbështetur nga Instituti Republikan Ndërkombëtar, për të ndërmarrë nismën për përgatitjen e një pakete me rekomandime ligjore për përmirësim të Kodit Zgjedhor. Kjo paketë paraqiti rekomandime konkrete për të mundësuar përfshirjen në proces votimi të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë të gjithë zgjedhësve me aftësi të kufizuar. Paketa me rekomandime ligjore u realizua nga një ekspert i fushës dhe në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të

FSHDPAK, si dhe u përfshinë në diskutime shoqatat e personave me aftësi të kufizuar.

Rekomandimet u prezantuan edhe në Koalicionin Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi i cili e mbështeti këtë nismë me një "Letër të Hapur" drejtuar institucioneve përgjegjëse, e cila u firmos nga anëtarët e Koalicionit dhe u shpërnda në rrjetin e bashkëpunëtorëve. Si edhe iu dërgua Komisionit të reformës zgjedhore dhe Komisionit të Kodit Zgjedhor, me kërkesën për ta bërë atë pjesë të ndryshimeve ligjore të Kodit të Ri. FSHDPAK dhe perfaqësues të Grupimit "Për përmirësimin e Kodit

Zgjedhor" organizuan në zyrat e FSHDPAK një takim me kryetarin e KQZ z. Çlirim Gjata. Organizatat i kërkuan z.Gjata që pavarësisht ndryshimeve të pritshme të Kodit Zgjedhor, KQZ duhet përgatisë dhe të shpërndajë një informacion me të dhëna për QV aktuale, aktualisht vendndodhjen e më pas nivelin e tyre të përshtatshmërisë. Gjithashtu u kërkua që në fushatën më të afërt zgjedhore KQZ të përfshijë në hapësirat publicitare çështjen e evidentimit dhe rregjistrimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe të parashikojë buxhet shtesë për disa përmirësime administrative në lidhje me aftësinë e kufizuar. Z. Gjata u tregua i gatshëm për bashkëpunim, duke ofruar edhe hartimin e një strategjie të përbashkët për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në takimin e zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm të Gjendjes Civile, iu kërkua mbështetje për gjetjen e mënyrave dhe mjeteve, duke bashkëpunuar edhe me pushtetin vendor, për evidentimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar. Edhe pse gjendja civile ka vetëm një pjesë të rolit në këtë proces, Drejtori i përgjithshëm ofroi mbështetjen e plotë të institucionit të tij.

Përfaqësues të Grupimit të shoqatave "Për përmirësimin e Kodit Zgjedhor", morën pjesë në takimin që Lëvizja Socialiste për Integrim organizoi në përgjigje të "Letrës së hapur" që ky grupim shpërndau. Drejtuesit e LSI mbështetën kërkesat e paraqitura dhe u angazhuan që t'i paraqesin ato në momentin e hartimit të kodit të ri zgjedhor.

Një takim u organizua me Ambasadorin e OSBE, z. Bosch dhe

personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri".

Qëllimi i kësaj tryeze ishte krijimi i një dialogu konstruktiv midis institucioneve përgjegjëse dhe organizatave jofitimprurëse për vënien në zbatim të rekomandimeve të këtij studimi dhe lobimin për ratifikimin e Konventës të OKB mbi

të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Parlamenti Shqiptar. Në këtë kontekst në tryezë morrën pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare (USAID, OSCE, Banka Botërore, PNUD-UNDP), përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të Qeverisë Shqiptare dhe përfaqësues të institucioneve të administratës publike, organizata jo fitimprurëse që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar, si edhe juristë dhe organizata të mirënjohura në fushën e të drejtave të njeriut. Një vend i veçantë iu kushtua prezantimit të gjetjeve të këtij raporti studimor, si në planin krahasimor ligjor por edhe atë financiar.

FSHDPAK është duke e ndjekur procesin e implementimit të rekomandimeve të studimit dhe procesin e lobimit për ratifikimin e Konventës së OKB.



stafin e tij ku u paraqitën përpjekjet që shoqatat e fushës së AK po bëjnë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së votes për zgjedhësit me AK. Ambasadori i Prezencës dhe përfaqësuesit e tjerë të OSBE, pjesëmarrës në takim vlerësuan punën e bërë dhe hodhën idene e koordinimit të përpjekjeve edhe me grupime të tjera të aftësisë së kufizuar. U ra dakort që të organizohet një tryezë me të gjitha organizatat e aftësisë së kufizuar, për të diskutuar më tej për një paketë të përbashkët rekomandimesh.

Tryeza e mbështetur nga OSBE dhe bashkëpunimin e INSIZ, në të cilën morën pjesë të gjitha shoqatat e fushës së aftësisë së kufizuar, u organizua në Qershor 2008. Në tryezë pjesëmarrësit u njohën me paketën me rekomandime ligjore të përgatitura nga FSHDPAK si edhe me një material me disa sugjerime të paraqitura nga Keshilli Kombëtar i personave me aftësi të kufizuar.

Pas Tryezës, Paketa e rekomandimeve, e përgatitur nga FSHDPAK, ku u përfshinë edhe sugjerimet e Këshillit, iu dërgua sërish Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Më tej përfaqësues të FSHDPAK organizuan dhe zhvilluan takime individuale ndërgjegjësuese me anëtarët dhe bashkëkryetarët e Komisionit, si edhe me ekspertët e këtij komisioni.

Përfaqësuesi i FSHDPAK u ftua për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore në Komisionin e Kodit Zgjedhor, e zhvilluar me grupet e interesit, për të bërë prezente dhe për të mbrojtur kërkesat për amendime ligjore të paraqitura pranë këtij komisioni. Problematika e prezantuar për realizimin e një procesi votimi të arritshëm nga të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuar pati vemendjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Përgjegjësia Sociale e Biznesit ndaj Njerëzve në Nevojë

Mësbhtetur nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS), përmes projektit "Nxitja e Përgjegjësisë Sociale të Komunitetit të Biznesit në Shqipëri ndaj Problematikave dhe të Drejtave të Grupimeve të Margjinalizuara", FSHDPAK mori iniciativën të vëzhgojë se sa koncepti i Përgjegjësisë Sociale të Biznesit (PSB) është i pranishëm në bizneset shqiptare, të ndërgjegjësojë të interesuarit mbi përgjegjësinë sociale të biznesit dhe të japë rekomandime për ndryshim.


Aktiviteti i projektit kishte për qëllim të theksonte rolin që biznesi mund e duhet të luajë në komunitetet ku ai vepron, si edhe të japë të dhëna aktuale mbi nivelin e përgjegjësisë sociale të biznesit në tre rajone të vendit, shkaqet e alternativat për ndryshim.

Iniciativa disa mujore e FSHDPAK konsistoi në:

1. Ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit mbi gjendjen e barrierat në të cilat ndeshen njerëzit me aftësi të kufizuara në Shqipëri (u organizuan një seri takimesh me biznese në të tre qytetet, u përgatit një fushatë ndërgjegjësuese në media).

2. Vendosjen e dialogut mes komunitetit të biznesit dhe organizatave në mbështetje të njerëzve me aftësi të kufizuara (u zhvilluan tre trajnime në të cilat morën pjesë 60 përfaqësues të shoqërisë civile).

3. Nxitjen e bashkëpunimit dhe rritjen e kontributit të biznesit në përgjigje të nevojave të komunitetit të njerëzve me aftësi të kufizuara (u zhvilluan seminare me pjesëmarrjen e 125 personave nga të gjitha grupet



e interesit në të tre rajonet; u përgatit një raport vëzhgimi me rekomandime për secilin nga grupet e interesit).

4. Lehtësimin e gjithëpërfshirjes së individëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e biznesit (i gjithë aktiviteti i zhvilluar ishte në funksion të realizimit të këtij objekti).

FSHDPAK, si pjesë aktive e Komunitetit të organizatave jofitimpruresë, synon të nxisë komunitetin e biznesit të ndikojë në ndryshime domethënëse të shoqërisë, ashtu si edhe Deklarata e Madridit synon; "Një shoqëri që përjashton apo lë jashtë saj qoftë edhe një anëtar të vetëm, është një shoqëri e

varfëruar. Inicativat që synojnë në përmirësimin e gjendjes të personave me aftësi të kufizuara, mund të ndikojnë në dizenjimin e një bote fleksibël për të gjithë".

Vëzhgimi u realizua në tre rajone të vendit, Shkodër, Korçë, Elbasan.

Aktorët e përfshirë në vëzhgim ishin komuniteti i bizneseve, organizata jofitimprurëse, Dhoma të Tregtisë, Zyra të Tatimeve, Zyrat Rajonale të Punësimit.

Disa nga gjetjet kryesore të këtij vëzhgimi vërtetojnë se:

- Koncepti i PSB është shumë pak i njohur dhe pothuajse i pazbatueshëm në vendin tonë.
- Kuadri ligjor aktual, mbi të cilin mund të mbështetet PSB është i paplotë dhe i pazbatueshëm.
- Dhomat e Tregtisë, Drejtoritë e Tatimeve, Zyrat e Punësimit, janë shumë pak të përfshira në procesin e nxitjes së PSB.
- OJF-të kanë pak njohuri mbi PSB e mbi mënyrat e një bashkëpunimi të frytshëm me të.
- Ka tendenca të PSB, të cilat janë sporadike, të paqëndrueshme dhe nisur vetëm nga elementë bamirësie.
- Ekziston një frymë pozitive për të marrë nisma të strukturuar në drejtim të hartimit të strategjive të PSB nga një numër i konsiderueshëm biznesesh.
- Ekziston një frymë pozitive bashkëpunimi nga komuniteti i biznesit në rast se kuadri ligjor përmirësohet në dobi të nxitjes së PSB.

Ndihmë ligjore të mbijetuarve të tragjedisë në Gërdec

Në zyrën e FSHDPAK, në Tiranë e Durrës, përgjatë periudhës Mars -Maj 2008, ka patur një numër të madh telefonatash, jo vetëm nga personat me aftësi të kufizuara të cilët kërkojnë të marrin informacion të vazhdueshëm ligjor por edhe për shkak të tragjedisë të ndodhur në Gërdec. 54 telefonata u regjistruan gjatë kësaj periudhe për çështje dhe problematika ligjore të aftësisë të kufizuar nga persona të prekur nga kjo tragjedi.

Koordinatori i programit ligjor të FSHDPAK dhe Avokati i Zyrës Ligjore në Durrës asistuan të mbijetuarit nga tragjedia e Gërdecit pranë kampeve të pushimit në qytetin e Durrësit. Informacion dhe konsulencë ligjore mbi problematikat ligjore për



çështjet e aftësisë të kufizuar i'u ofrua 25 personave në nevojë.

Prej Janarit 2008, në zyrën e Durrësit është angazhuar vullnetarisht një psikologe, e cila u ofroi mbështetje të vazhdueshme psikologjike të mbijetuarve të tragjedisë së Gërdecit gjatë qëndrimit të tyre në qytetin e Durrësit.

Trajnim "Teknika të Punës Kërkimore dhe Vlerësimit të Programeve"

Nën drejtimin e Marita Nika Flagler, Ph.D. MSW, Stafit i FSHDPAK, është përfshirë në një kurs trajnimi mbi "Teknika të Punës Kërkimore dhe Vlerësimit të Programeve". Kursi synon të zhvillojë tek pjesëmarrësit aftësi dhe shprehje profesionale të avancuara për kërkimin shkencor dhe vlerësim programi.

Kursi ishte intesiv, përfshiu leksione, ushtrime dhe aktivitetet, eksperiencë praktike, pune dhe projekte individuale dhe në grup

dhe u zhvillua në dy seanca. Gjatë seancës së parë të trajnimit, u punua me të gjithë grupin për një periudhë 10 ditore. Gjatë pjesës së dytë të trajnimit, Korrik 2008-Dhjetor 2008, u punua në mënyrë individuale me pjesëmarrësit për projektet e tyre specifike. Secili nga pjesëmarrësit po punon mbi një projekt kërkimor/vlerësim programi.

Ky trajnim u realizua në kuadrin e programit të FSHDPAK, mbështetur nga USAID.

K. R është nxënës në shkollën 9-vjeçare "Sevasti Qirazi" në qytetin e Korçës. Një gazetare e RTV Korça u informua nga të afërm të K.R rreth një problemi që kishte fëmija 11 vjeçar me shikimin. Ky komplikacion i ishte shkaktuar fëmijës pas një ataku në retinë dhe ai kishte humbur shikimin në njërin sy. Nëse nuk i nënshtrohej një ndërhyrje të kushtueshme kirurgjikale, fëmija rrezikonte të humbiste shikimin edhe në syrin tjetër. Për shkak të gjendjes së tij K.R nuk mundej të frekuentonte shkollën dhe kishte rreth një muaj që ishte shkëputur prej saj.

Historia e K.R u bë publike në edicionet informative të televizioneve lokale të Korçës për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve vendore, bizneseve, shoqatave dhe qytetarëve të

Shpirti human dhe ndërgjegjësimi i qytetit të Korçës i riktheu shikimin nxënësit K. R

Korçës për të ofruar ndihmë financiare familjes së fëmijës (e cila jetonte në kushtet e një varfërie ekstreme) me qëllim përballimin e operacionit tepër të nevojshëm për shikimin e tij.

Ashtu si dhe në raste të tjera, publikimi i historisë dhe thirrja për ndihmë drejtuar komunitetit, dha rezultatin e pritshëm. Drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me qeveritë e nxënësve organizuan fushata të mbledhjes të fondeve. Një pjesë e biznesmenëve të qytetit të Korçës reagueshan duke dhënë kontributin e tyre.

Qytetarë të thjeshtë brenda mundësieve dhuronin shuma në para për të shpëtuar shikimin e fëmijës të prekur nga sëmundja e rëndë. Një kontribut të ndjeshëm dha për këtë qëllim edhe FSHDPAK, i cili jo vetëm kontribuoi në ndërgjegjësimin e qytetarëve, por edhe ndihmoi financiarisht për ndërhyrjen kirurgjikale të fëmijës K.R.

Shuma e grumbulluar në kohë, mundësoi ndërhyrjen kirurgjikale dhe i riktheu shikimin fëmijës. TVK publikoi një tjetër kronikë pas operacionit, duke përcjellë me këtë rast edhe falenderimin publik për të gjithë ata që kontribuan në këtë akt human dhe bënë të mundur që K.R t'i rikthehej shkollës dhe si të gjithë fëmijët e tjerë.

**Benila Terova, Gazetare
Av. Evis Mico, FSHDPAK, Dega Korçë**

Shoqëria civile dhe përpjekjet për gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë

Shteti i ri i Kosovës, përveç sfidave komplekse që mbart, po përballët tashmë edhe me sfidën e gjithëpërfshirjes të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri. Shoqëria civile në Kosovë është një komponent i rëndësishëm dhe po luan një rol të përkushtuar në këtë drejtim. "Handikap Kosova" është një nga organizatat joqeveritare që vepron në Kosovë. Kjo organizatë ka si mision primar ofrimin e informacioneve mbi aftësinë kufizuar, organizim të aktiviteteve kulturore dhe sportive për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ofrimin e trajnimeve profesionale me qëllim punësimin e tyre.

Ndër projektet e suksesshme të kësaj organizate është implementimi i projektit të quajtur "Pesë të parët" që ka të bëjë me shkollimin e pesë studentëve me aftësi të kufizuar në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. Një hap tjetër pozitiv i punës së kësaj organizate është arritja e bashkëpunimit me Radion "Blue Sky" që mundëson transmetimin e emisionit "Zëri i Arsyës". Emission ky që ka për qëllim sensibilizimin e opinionit mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, duke

promovuar punën dhe arritjet e personave me aftësi të kufizuar.

Shoqata "Down Syndrom Kosova" ka realizuar një aktivitet tjetër të rëndësishëm për personat me Sindromën Dawn në Prishtinë, të cilët janë identifikuar në një numër prej 520 raste (numër që pretendohet të jetë më i lartë, për shkak të mungesës të të dhënave zyrtare). Kjo shoqatë ka mundësuar hapjen e një "Bar-Kafe" ambjent i cili do të shërbejë jo vetëm për të bashkëbiseduar dhe ndarë informacionin midis vetë personave dhe rrjetit të prindërve, por edhe për të zhvilluar aktivitete të ndryshme duke përfshirë në të anëtarë të tjerë të komunitetit në Prishtinë.

Pavarësisht nga barrierat dhe vështirësitë që hasin personat me aftësi të kufizuar në Kosovë, ka edhe gjera të cilat ecin përpara. Në këtë kënd është për tu përhëndetur puna e Kuvendit Komunal të Prishtinës i cili ne vitin 2005 beri vendosjen e semaforëve akustik me zë në qytetin e Prishtinës për personat e verbër, në mënyrë që qasja e tyre në trafik të jete me e lehtë.

Po ashtu vlen të theksohet që gjatë

vitit 2008 ka filluar punën grupi punues për hartimin e "Strategjisë Nacionale të Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës", draft i cili para se të finalizohet do behet publik, më 3 Dhjetor, ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuar.



Gjithashtu në Kosovë po punohet që shume shpejt bizneset private dhe institucionet publike të stimulohen nga shtetit me qëllim formimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Megjithatë mbetet akoma për të bërë ndryshime që personat me aftësi të kufizuar në Kosovë të ushtrjnë të drejtat e tyre mbi baza të barabarta me gjithë individët e tjerë në shoqëri.

Zj. Ganimete Beqiri
Koordinatorë "Handikap Kosova"
Email: zarsye@yahoo.com
Tel: +377 44 550 517